

## MENDIM PAKICE

1. Unë, komisionere Etleda Çiftja, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Suela Salavaçi, vendim i cili ka konfirmuar në detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, subjektin e rivlerësimit.

2. Kam votuar kundër vendimit të shumicës duke mbajtur qëndrimin se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit e në kundërshtim me faktet, të cilat kanë rezultuar nga hetimi administrativ kryesisht.

3. **Për rivlerësimin e pasurisë** – si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve që: (i) kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht; ose (ii) nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ekzistencën e të ardhurave të ligjshme dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

4. Unë, si anëtare në pakicë, ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e shumicës së trupit gjykues për këtë kriter, kam vlerësuar si vijon:

***Lidhur me pasurinë apartament banimi në Tiranë, me sipërfaqe 121.3 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë***

5. Në deklaratën Vetting 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament banimi me sipërfaqe 121.3 m<sup>2</sup>, me adresë në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, blerë sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 20.11.2013, në vlerën 38.800 USD dhe deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 2.11.2013. Apartamenti është porositur dhe paguar nga nëna ime sipas kontratës së porosisë datë 10.3.2005. Burimi i krijimit: të ardhura të familjes nga kontratat e qirave, shitja e pasurive të paluajtshme etj.”.*

- *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri dhe personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit/dhuresi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në një vlerë prej 6,116,309 lekësh për të justifikuar pasurinë e deklaruar në deklaratën Vetting dhe, për rrjedhojë, gjendet në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, sipas vlerësimit më poshtë:*

**5.1** Subjekti në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar në seksionin “Ndryshimet në pasuri dhe burimi i krijimit”, apartament pa përshkruar burimin e krijimit, vlefte 38,800 USD, pjesa në përqindje 100. Siç rezulton edhe nga deklarimi, subjekti nuk e ka deklaruar në mënyrë të saktë këtë pasuri në vitin 2013.

**5.2 Lidhur me burimin e krijimit** – ndryshe nga shumica e trupit gjykues, kam arritur në konkluzionin se personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit, në cilësinë e dhuresit të këtij apartamenti, nuk ka burime të ligjshme, të mjaftueshme në datën e kryerjes së pagesës, 10.3.2005, në shumën 38,800 USD, për shkak se nga analiza financiare e kryer nga Njësia

Ligjore pranë Komisionit rezulton me mungesë të burimeve financiare në vitin 2005, në shumën 6,116,309 lekë, duke pasur një vlerësim ndryshe nga shumica lidhur me sa vijon:

***Lidhur me të ardhurat e qirasë nga tezja e nënës, znj. E. Dh. (K.)***

**5.3** Mospërfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të tezes së nënës subjektit, përfituar nga trashëgimia: (1) të ardhurat e tezes së subjekti përfituar nga trashëgimia në shumën 1,297,587 lekë nga qiraja e godinës së ish-Ambasadës Franceze; dhe (2) të ardhurat e e përfituara nga tezja e subjektit si trashëgimtare nga kontrata e shitjes së pasurisë trashëgimore në shumën 11,313.4 USD, në datën 20.9.2002. Sipas vlerësimit tim, këto të ardhura nuk duhet të merren në konsideratë si burim krijimi i kësaj pasurie, sikundër pretendon subjekti, për shkak se: (i) ky burim krijimi nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 dhe/ose në DPV nga subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016 dhe akteve në zbatim të tij; ky burim është shtuar nga subjekti vetëm gjatë hetimit administrativ shtesë të Komisionit; (ii) këto të ardhura sipas dëshmisë së trashëgimisë dhe pjesës takuese janë ligjërisht të tezes së subjektit dhe jo nënës së subjektit; si dhe (iii) nuk ka provë shkresore, që të vërtetojë posedimin e këtyre të ardhurave nga nëna e subjektit dhe, si e tillë, mbetet në nivel deklarativ dhe jo në harmoni me provat e tjera të administruara gjatë procesit. Pas kalimit të barrës së provës lidhur me këtë konstatim, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ dhe kjo pasaktësi/mosdeklarimi si burim merr rëndësi në rastin konkret, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar pasuritë.

***Mospërfshirja në analizën financiare e të ardhurave të pretenduara nga aktmarrëveshja e datës 29.4.2003***

**5.4** Trupi gjykues i kaloi subjektit barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën e rezultatit se: (i) në lidhje me shumën 15.500.000 lekë, të përfituar nga aktmarrëveshja e datës 29.4.2003, Komisioni, në analizë financiare nuk e ka konsideruar këtë pagesë, pasi nuk u provuan pagesat e detyrimeve tatimore; (ii) pavarësisht se nëna e subjektit L. S. nuk ka pasur detyrimin ligjor për deklarim të pasurive dhe të të ardhurave, duket i dyshimtë fakti se subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash kontrata të tjera të nënës dhe nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* aktmarrëveshjen datë 29.4.2003, si një burim i konsiderueshëm ndër burimet e tjera të deklaruara nga ana e subjektit.

**5.5** Pas kalimit të barrës së provës lidhur me këtë konstatim, subjekti nuk paraqiti shpjegime bindëse mbi dyshimet e ngritura nga Komisioni, si dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ lidhur me pagimin e tatimit. Kjo pasaktësi/mosdeklarimi si burim krijimi i kësaj aktmarrëveshjeje në deklaratën *Vetting* 2017 merr rëndësi në rastin konkret për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar pasuritë. Për këtë arsye, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, unë kam vlerësuar:

**5.6** Sipas pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 [...] *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...].*

**5.7** Unë, si anëtare në pakicë, çmoj se kjo provë (aktmarrëveshja) e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të justifikuar burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur/nënës është në papajtueshmëri të dukshme me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit dhe është e pabesueshme, për shkak se:

- i) Subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 këto të ardhura të personit tjetër të lidhur, detyrim ky i parashikuar në pikën 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës<sup>1</sup>, i interpretuar bashkë me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016<sup>2</sup> dhe pikave 18 dhe 19 të udhëzimit nr. \*\*\*, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së. Ky burim krijimi nga aktmarrëveshja nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në seksionin “Të dhëna konfidenciale”, sikundër ka deklaruar dokumentacionin ligjor justifikues për të ardhurat nga burimet e kontratave të qirave dhe shitjes së personit tjetër të lidhur/nënës së subjektit.
- ii) Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar si burim të ardhurash në DIPP-të vjetore këtë aktmarrëveshje sipas kërkesave të ligjit nr. 9049, kryesisht në vitin 2003 kur deklaroi për herë të parë, dhe në vitin 2013 kur deklaroi blerjen e kësaj pasurie/apartamenti objekt analizimi, prova të cilat mund të merren në konsideratë sipas parashikimeve të pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.
- iii) Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar për herë të parë këto të ardhura të përfituara nga aktmarrëveshja e datës 29.4.2003 si burim krijimi për pasuritë, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të dërguar nga Komisioni<sup>3</sup>, në datën 2.11.2022, pra gjatë hetimit administrativ dhe vetëm pas pyetjeve të drejtuara nga Komisioni. Unë, si anëtare në pakicë, çmoj të nënvizoj qëndrimin se objekt i punës së organeve të rivlerësimit është kontrolli i vërtetësisë së deklarimeve të subjekteve të rivlerësimit të kryera në deklaratën *Vetting* dhe verifikimi i burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive. Procesi hetimor administrativ i zhvilluar prej organeve të rivlerësimit nuk mund të jetë një proces që fton/lejon subjektet të bëjnë deklarime të reja, më të volitshme për vlerësimin e pasurisë së tyre. Subjekteve i kërkohet të japin shpjegime e të paraqesin prova që mbështesin deklaratimet e tyre dhe jo të modifikojnë deklaratimet në përputhje me problematikat e prezantuara.
- iv) Nga hetimi nuk ka rezultuar që këto të ardhura me burim aktmarrëveshjen e vitit 2003, të jenë deklaruar në ndonjë prej organeve shtetërore nga ana e personit tjetër të lidhur/nënës së subjektit.
- v) Në kohën që pretendon subjekti se është nënshkruar aktmarrëveshja, në vitin 2003, personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit nuk e kishte dokumentacionin ligjor për pronësinë e kësaj sipërfaqeje me qëllim që ta jepte për zhvillim. Nuk ka logjikë ligjore dhe financiare që një investitor t’i paguajë një shumë kaq të konsiderueshme (15,500,000 lekë) nënës së subjektit, e cila nuk ka dokumentacion që të vërtetojë pronësinë apo të drejtat reale mbi to.
- vi) Subjekti nuk paraqiti ndonjë provë, e cila provon se kjo aktmarrëveshje është ekzekutuar/paguar. Pra, nuk ka të dhëna apo dokumentacion ligjor justifikues që provon se nëna e subjektit ka marrë shumën 15,500,000 lekë në vitin 2003 nga kjo aktmarrëveshje.

---

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Sipas ligjit nr. 84/2016, neni 30, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

<sup>2</sup> Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

<sup>3</sup> Email datë 2.11.2022, ora 11:04, me subjekt: “Përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 11.10.2022”.

- vii) Subjekti nuk provoi se mbi këtë pronë të pretenduar të nënës së subjektit të kishte pasur zhvillim në vitin 2003, me qëllim që të justifikojë ekzekutimi/pagimi i kësaj shume. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga vetë subjekti, aktmarrëveshja e datës 21.8.2012, në kreun I “Objekti”, në paragrafin e fundit citon: “[...] **Mbi këtë sipërfaqe ndodhen aktualisht ndërtime të vjetra dhe sipërfaqe truall prej 700 m<sup>2</sup> për të cilën palët kanë lidhur dhe nënshkruar kontratë, ...për shitje me rezervë të pronës [...]**”. Gjithashtu, në deklaratën e lëshuar nga administratori i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., z. J. K., deklarohet se në këtë pronë janë vënë vetë disa çadra kampingu nga viti 2009. Pra, nuk ekziston ndonjë e dhënë e cila të provojë se investitori ka zhvilluar pronën nga viti 2003.
- viii) Kjo e ardhur e pretenduar si e përfiturar në vitin 2003 (që sipas deklaramit të subjektit është parapagim) nuk është përfshirë në aktmarrëveshjen e vitit 2012<sup>4</sup>, e firmosur midis bashkëtrashëgimtarëve të kësaj prone (përfshirë dhe nënën e subjektit) me të njëjtin ortak të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. (A. Xh.), për të njëjtin qëllim dhe për të njëjtën sipërfaqe prone. Pretendimet e subjektit për mospërfshirjen e aktmarrëveshjes së vitit 2003 në aktmarrëveshjen e vitit 2012, mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara.
- ix) Një fakt tjetër i rëndësishëm i cili vë në dyshim ekzistencën e kësaj aktmarrëveshje është deklarimi i subjektit gjatë hetimit se nuk ka qenë në dijeni të kësaj aktmarrëveshje të firmosur nga nëna e saj, ndërkohë që në DPV-re të vitit 2004 ka deklaruar një depozitë bankare në emër të tij, në shumën 52.543 USD, të depozituara nga vetë subjekti, për të cilën pretendon se kanë burim aktmarrëveshjen e vitit 2003. Në këto rrethana, duke qenë se sipas ligjit Nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, në subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për deklarimin e burimit të krijimit të kësaj depozite në DPV-në e vitit 2003 dhe 2004, dhe për rrjedhojë do të duhet të ishte në dijeni dhe të kësaj aktmarrëveshje. Arsyetimi në të kundërt nuk ka kuptim në këtë rast. Për rrjedhojë pretendimi i subjektit lidhur me mosdijeninë e ekzistencës së kësaj aktmarrëveshje nuk është i besueshëm.

**5.8** Referuar në sa më lart arsyetuar, në kushtet kur aktmarrëveshja e vitit 2003: (i) nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting 2017* dhe ndër vite pranë ILDKPKI-së si burim për krijimin e pasurive të nënës së subjektit; (ii) deklarohet për herë të parë në pyetësin nr. 3 të hetimit të Komisionit, pasi ishte njohur me mungesën e dokumentacionit për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive; (iii) nuk ishte nënshkruar nga personi që e kishte këtë prone, pasi nëna e subjektit nuk e kishte pronën të kthyer qoftë me vendim të KKKP-së në vitin 2003; (iv) ka mungesë të provave të cilat vërtetojnë se kjo aktmarrëveshje është ekzekutuar, pra t’i jetë paguar vlera 15,500,000 lekë nënës së subjektit; (v) nuk provoi se në këtë pronë ka filluar ndërtimi që nga viti 2003; (vi) nuk është përfshirë aktmarrëveshja e vitit 2003 dhe ekzekutimi i saj në aktmarrëveshjen e nënshkruar më 21.8.2012, për të njëjtën pronë dhe sipërfaqe; si dhe (vii) fakti që vetë marrëveshja e vitit 2012 citon se nuk ka ndërtime në këtë pronë, aktmarrëveshja e vitit 2003 është dukshëm në papajtueshmëri me provat e tjera të administruara gjatë procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, të krijohet bindja se kjo aktmarrëveshje është siguruar gjatë procesit të rivlerësimit me qëllim mbulimin me të ardhura ligjore të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

<sup>4</sup> Aktmarrëveshja nr. \*\*\*, datë 21.8.2012.

**5.9** Në këto rrethana, akmmarrëveshja e vitit 2003 që ka shërbyer si burim për të ardhurat 15 500 000 lekë nuk është e besueshme dhe më tej e parë dhe e vlerësuar në raport me faktet e tjera, e bën, sipas vlerësimit tim, këtë aktmarrëveshje pa vlerë provuese për procesin e rivlerësimit.

**5.10** Në konkluzion të vlerësimit të aktmarrëveshjes së vitit 2003, unë, si anëtare në pakicë, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurive, si dhe nuk arriti të provojë se personi tjetër i lidhur e ka përfituar shumë prej 15,500,000 lekësh në vitin 2003, si parapagim, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**5.11** Në konkluzion të analizimit të deklarimit dhe burimit të krijimit të apartamentit me sip. 121.36 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, unë arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri dhe personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit/dhuruasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në një vlerë prej 6,116,309 lekësh për të justifikuar pasurinë e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe, për rrjedhojë, gjendet në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit Kushtetutës dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

#### ***Pasuria 2 – apartament me sipërfaqe 84 m<sup>2</sup>, 2+1, në G.***

**6.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament me sipërfaqe 84 m<sup>2</sup>, 2+1, blerë sipas kontratës së porosisë datë 20.3.2012, në vlerën 72,000 euro, apartament i porositur nga babai P. S., sipas deklaratës noteriale datë 8.2.2005 dhe kontratës së porosisë datë 8.10.2010. Burimi i krijimit: të ardhura të familjes; nga kontratat e qirave; shitja e pasurive të paluajtshme; të ardhurat nga vëllai në Itali, etj.*”

**6.1** Subjekti, në DIPP-në e vitit 2012, ka deklaruar në seksionin “Ndryshimet në pasuri dhe burimi i krijimit”, kontratë porosie apartament 2+1, pa përshkruar burimin e krijimit, vlefte 72,000 euro, pjesa në përqindje 100. Siç rezultojnë edhe nga deklarimi, subjekti nuk e ka deklaruar në mënyrë të saktë këtë pasuri në vitin 2012, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049.

**6.2 Në rezultatet e hetimit kryesisht**, ndryshe nga sa referon shumica në vendimin e saj (paragrafët 20.36 dhe 20.37), trupi gjykues i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit se personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka rezultuar me balancë negative për pagimin e apartamentit si vijon: (i) për pagesën e kështit të parë në shumën 20,000 euro, paguar në shkurt 2005<sup>5</sup>, ka rezultuar me një balancë negative për të gjithë këstin në shumën 20,000 euro ose e konvertuar në 2,450,800 lekë, kryer në shkurt 2005; (ii) për pagesën e kështit të dytë në shumën 23,000 euro (17,000 euro kësht + 6,000 euro mobilim) e kryer në tetor të vitit 2010 – vetëm gjatë hetimit subjekti ka deklaruar si burim edhe një kredi të tërhequr *cash* në shumën 2,450,000 lekë në NBG në janar 2010; kjo shumë e tërhequr mund të ketë shërbyer për pagesën e këtij kështi; (iii) për pagesën e kështit të tretë në shumën 27,000 euro në vitin 2012 (25,000 + 2,000) si pagesë e fundit për apartamentin në muajt mars-maj 2012 – ka rezultuar një balancë negative në shumën 3,947,630 lekë; (iv) për vitet 2005 dhe 2012 ka rezultuar se prindërit e subjektit nuk kanë pasur mundësi për blerjen e apartamentit,

<sup>5</sup> Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 8.2.2005.

pasi ka rezultuar një balancë negative totale në shumën 6,398,430 lekë (3,947,630 lekë + 2,450,800 lekë).

### ***Lidhur me burimin e krijimit***

**6.3** Bazuar në rezultatet e hetimit kryesisht dhe prapësimet e paraqitura nga subjekti, unë, si anëtare në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj:

- i) *Për këstin e parë* – paguar në shkurt të vitit 2005 në shumën 20,000 euro (2,450,800 lekë), subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe personi tjetër i lidhur/babai i subjektit në cilësinë e dhuruesit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare në shumën 20,000 euro për të paguar këtë këst. Vlerësimi im bazohet në arsyetimin e mungesës së burimeve të ligjshme në pikën 5 më lart (mospërfshirja e të ardhurave nga tezja), duke qenë se edhe apartamenti i trajtuar në pikën 5 dhe kësti i parë janë paguar në të njëjtin vit, 2005.
- ii) *Për këstin e dytë* – ndryshe nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se nëse do të marrim të mirëqenë deklarimin e subjektit se kredia e marrë pranë NBG-së nga nëna e subjektit ka shërbyer për këstin e dytë, është shlyer nga vetë ajo me të ardhurat e saj, atëherë subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar këtë fakt dhe, për rrjedhojë, pjesën takuese në këtë apartament në DIPP-në e vitit 2010.
- iii) *Për këstin e tretë* – vlerësoj se personi tjetër i lidhur/dhuruesi nuk provoi se kishte të ardhura të ligjshme financiare lidhur me pagesën e kryer në vitin 2012. Vlerësimi im bazohet në arsyetimin e mungesës së burimeve të ligjshme në pikën 5 më lart, duke qenë se subjekti në deklarimin e saj në deklaratën *Vetting* ka përdorur të njëjtat burime krijimi si për apartamentin e parë edhe për këtë apartament.

**6.4** Në analizimin e burimit të ligjshëm financiar për pagimin e këtij apartamenti nga babai i subjektit, dhuruar subjektit në vitin 2012, rezulton se personi tjetër i lidhur/dhuruesi ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 3,947,630 lekë për pagesat e kryera për këtë apartament.

**6.5** Ndryshe nga shumica e trupit gjykues lidhur me këtë pasuri, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe, për rrjedhojë, të pasurisë dhe se personi tjetër i lidhur/babai i subjektit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, duke e vendosur subjektin në kushtet e pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### ***Lidhur me gjendjen e likuiditeteve cash në shumën 10,000 euro***

**7.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Gjendje cash në shumën 10.000 euro, si rezultat i shitjes së një pasurie të paluajtshme në vitin 2012, nga nëna. Burimi i krijimit: nga shitja e pasurisë së paluajtshme me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2012*”.

**7.1** Ndryshe nga shumica e trupit gjykues, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se lidhur me deklarimin e likuiditetit në formën *cash* duhet të analizohen deklarimet vjetore si provë e rëndësishme e përcaktuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për të verifikuar deklarimin e likuiditetit në formën *cash* në deklaratën *Vetting*.

**7.2** Duke qenë se subjekti: (i) nuk i ka deklaruar shumën 10,000 euro në DPV-në e vitit 2015 si likuiditet në formën *cash* (momentin e tërheqjes nga llogaria e saj të shumës 14,500 euro); (ii) nuk ka deklaruar as në DPV-në e vitit 2016 likuiditet në formën *cash* në shumën 10,000 euro; dhe më tej (iii) në DPV-në e vitit 2017 subjekti nuk e ka deklaruar as si likuiditet në formën *cash*, por as si dhurim, unë vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditetit në formën *cash*.

**7.3** Më tej, sipas analizës financiare të kryer për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, në vlerën 2,264,649 lekë.

**7.4** Lidhur me këtë situatë faktike, unë, si anëtare në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditetit në formën *cash*, ka kryer deklarim të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të tij në deklaratën e pasurisë (*Vetting*) në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim shmangien nga kontrolli, në kuadër të procesit të rivlerësimit të pasurisë së tij në formën e likuiditetit *cash* (jashtë sistemit bankar), për shkak se rezultoi me pamundësi të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

***Lidhur me verifikimin e saktësisë së deklarimit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit cash***

**8.** Trupi gjykues i kaloi subjektit barrën e provës me konstatimin se: (i) *Duket se kursimet e deklaruara nga subjekti në deklarimet periodike vjetore ndër vite nuk përputhen me gjendjen kumulative të kursimeve nga viti 2007 deri në vitin 2016, të cilat duhet të ishin në vlerën 6,095,925 lekë, nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve;* (ii) *Nga analiza financiare e përgjithshme e subjektit për periudhën 2007 – 2016, duket se kanë rezultuar balanca negative në vitet 2007, 2012, 2013, 2014 dhe 2015, të cilat shkojnë në shumën totale 6,229,990 lekë.*

**8.1** Shumica e trupit gjykues pas prapësimeve të subjekti ka konsideruar pretendimet e subjektit lidhur me saktësinë e deklarimit duke e rishikuar analizën financiare dhe duke i marrë deklarimet e subjektit në DIPP si gjendje likuiditetesh në fund të vitit.

**8.2** Unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se ky konkluzion i shumicës nuk bazohet në leximin e DPV-ve vjetore si provë në këtë proces (pika 5 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, ligji nr. 90/49 dhe jurisprudenca tashmë e vendosur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit), për sa vijon:

**8.3 Lidhur me deklarimet në deklaratat periodike vjetore** – subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë deklaruar likuiditet në formën *cash* në DPV-të vjetore, si vijon: (1) Për vitin 2007, subjekti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 400 000 lekë; (2) Për vitin 2008, subjekti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 400 000 lekë; (3) Për vitin 2009, subjekti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 800 000 lekë; (4) Për vitin 2010, subjekti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 500 000 lekë dhe personi i lidhur/bashkëshorti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 500 000 lekë; (5) Për vitin 2011, subjekti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 500 000 lekë dhe personi i lidhur bashkëshorti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 500 000 lekë; (6) Për vitin 2012, subjekti deklaroi *kursime nga paga* në shumën 400 000 lekë; (7) Për vitin 2013, personi i lidhur/bashkëshorti deklaroi *kursime nga të ardhurat vjetore* në shumën 600 000 lekë; (8) Për vitin 2014, subjekti deklaroi *kursime nga paga* në

shumën 500 000 lekë; (9) Për vitin 2015, subjekti deklaroi *kursime nga paga Banka Kredins* në shumën 511 900 lekë;

**8.4** Në DPV-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk deklaroi ndryshime të likuiditetit në formën *cash* dhe për rrjedhojë sipas leximit të deklarimeve të DPV-të 2007- 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë gjendje të likuiditeteve në formën *cash*, të akumuluar në fund të vitit 2016, në shumën 6 095 925 lekë. Ndërkohë që, subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën vetting 2017, *Cash* 10 000 Euro, nga kontrata e shitjes.

**8.5** Referuar nenit 5/1 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Deklarimi para fillimit të detyrës” dhe “Deklarimi i parë”, të cilët për nga natyra e deklarimit janë të njëjtë, përcaktohet detyrimi i subjekteve deklaruese për të deklaruar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit apo në vijim nga momenti i fillimit të detyrës të gjitha pasuritë e akumuluar dhe detyrimet financiare të tyre. Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e të njëjtit ligj, në objektin e deklarimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje *cash*, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri.

**8.6** Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave privatë, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat pakësimet) [...] e çdolloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.*

**8.7** Në analizë të sa më sipër, legjislacioni në fuqi që përcakton mënyrën, llojin, objektin dhe afatin e deklarimit të pasurisë dhe interesave privatë ka qenë më se i qartë në drejtim të përcaktimit të detyrimit për deklarim dhe mënyrës së deklarimit.

**8.8** Gjithashtu, Kolegji i Posaçëm i Apelit në jurisprudencën e tij në një sërë vendimesh duke filluar nga viti 2019 ka qenë konsistent lidhur me interpretimin e deklarimit të likuiditeteve *cash* të deklaruara nga subjektet e rivlerësimit.

**8.9** Në vijim të sa më sipër, unë, si anëtare në pakicë, çmoj se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklarimeve të kursimeve në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar se subjekti ka deklaruar gjendjen e kursimeve dhe jo shtesat, është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe pretendim alogjik në kuptim të nocionit të kursimit.

**8.10** Lidhur me verifikimin e saktësisë së deklarimit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar kursimet e deklaruara në formën e likuiditetit *cash*, rezulton se pasuritë e deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të në formën e likuiditeteve *cash* (jashtë sistemit bankar) arrin vlerën totale prej 6,095,925 lekësh.

**8.11** Nga analiza financiare e kryer nga Njësia Ligjore pranë Komisionit, për periudhën 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, rezultojnë me pamjaftueshmëri të



burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vlerën 6,284,267 lekë.

**8.12** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në prapsimet e paraqitura kundrejt barrës së provës, se në DPV 2007 -2015 ka deklaruar gjëndjen e likuiditeteve dhe jo shtesat, sipas vlerësimit tim nuk qëndron edhe për shkak të deklarimit në procesverbalin e mbajtur në datën 7.7.2016 pranë ILDKPKI-së, administruar si provë gjatë hetimit, në të cilin subjekti ka deklaruar se gjendja e kursimeve *cash* deri në datën 31.12.2014 është në vlerat 1,000,000 lekë dhe 5,000 euro. Nëse do të ishte i vërtetë pretendimi i subjektit se ka deklaruar gjendje të këtij lloji likuiditeti dhe jo shtesa, atëherë në këtë procesverbal subjekti duhet të kishte deklaruar 500,000 lekë gjendje (sipas deklarimit në DPV-në e vitit 2014), ndërkohë që subjekti ka deklaruar 1,000,000 lekë dhe 5,000 euro. Ky ndryshim qëndrimi i subjektit lidhur me mënyrën e deklarimit të DPV, duket të jetë bërë në funksion të balancave negative për të cilat subjekti i kaloi barra e provës së dërguar nga Komisioni.

**8.13** Lidhur me këtë situatë faktike, unë, si anëtare në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditetit në formën *cash*, ka kryer deklarim të paplotë dhe të pasaktë të pasurive të tij në deklaratën e pasurisë (*Vetting*) në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim shmangien nga kontrolli, në kuadër të procesit të rivlerësimit, të pasurisë së tij në formën e likuiditetit *cash* (jashtë sistemit bankar), për shkak se rezultoi me pamundësi të burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

#### ***Lidhur me depozitën dyemërore (L. S. ose Suela Salavaçi) në BKT***

**9.** Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017: “*Depozitë në BKT dyemërore (L. S. ose Suela Salavaçi), bashkëmbajtëse me prindërit në vitin 2012, ku gjendja në datën 20.1.2017 është 67,496 USD. Burimi: të ardhura të familjes nga kontratat e qirave; shitja e pasurive të paluajtshme; të ardhura nga vëllai në Itali etj.*”.

**9.1** Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka hapur një llogari depozitë në dollar, në emrin e saj (znj. Suela Salavaçi), në datën 11.6.2003 dhe e mbyllur më 1.2.2010 dhe, më tej, një llogari depozite në dollar, në emër të shtetasës L. S., e hapur në datën 4.2.2005 dhe e mbyllur më 17.4.2019.

**9.2** Duke qenë se fillimisht kjo llogari është hapur në vitin 2003 nga ana e subjektit dhe burimet janë të njëjta me ato të deklaruara dhe për apartamentet e dhuruara nga nëna dhe babai (apartamenti në Tiranë dhe G., arsyetuar më lart), nga të ardhurat e aktmarrëveshjes datë 29.4.2003, referuar analizës ligjore dhe ekonomike të kryer më lart në pikën 5 të këtij dokumenti, në të cilin unë, si anëtare në pakicë, nuk i marr në konsideratë të ardhurat nga aktmarrëveshja, arrij në konkluzionin se:

**9.3** Subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur/nëna nuk kanë burime financiare të ligjshme për të krijuar këto depozita, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

***Lidhur me llogaritë e vazave K. M. (11,652 USD) dhe K. M. (6,462 USD) me burim dhurime nga nëna e subjektit të rivlerësimit***

**10.** Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve se: *Referuar analizës progresive të prindërve për periudhën 2004 – 2016, duket se për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2011, 2012, 2014, 2015 dhe 2016 ka rezultuar me balanca negative e, për rrjedhojë, duket se nëna nuk ka pasur mundësi financiare për këto depozitime në llogari të vajzës.*

**10.1** Nëna e subjektit, si dhuruese e këtyre të ardhurave, ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave. Ndryshe nga shumica e trupit gjykues, unë vlerësoj se pas prapësimeve subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës, duke mos paraqitur dokumentacion për të provuar të ardhurat e ligjshme.

**10.2** Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të krijuar depozitat e vajzave në shumat 11,652 USD dhe 6,462 USD, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### ***Lidhur me shpenzimet për udhëtime dhe dhurimet nga një shoqëri udhëtimi për subjektin dhe familjen e saj***

**11.** Në pyetësonin standard, subjekti ka deklaruar se disa nga udhëtimet e saj dhe familjarëve të saj jashtë shtetit janë financuar personalisht nga mikeshja E. Gj., administratore e shoqërisë “\*\*\*\*”, udhëtime në të cilat ka qenë edhe znj. Gj. dhe/ose familjarë të saj.

**11.1** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.9.2020, të lëshuar nga shtetasja E. Gj., e cila, ndër të tjera, deklaroi se me Suela Salavaçin ka marrëdhënie shumë të ngushta familjare, ku subjekti së bashku me familjarët e saj kanë qenë disa herë të ftuar nga znj. Gj., konkretisht në 3 udhëtime në \*\*\*, \*\*\* e \*\*\*<sup>6</sup>, si dhe ka qenë e ftuar dhe është pritur prej saj në udhëtime në SHBA<sup>7</sup>, ku çdo shpenzim është përballuar prej saj.

**11.2** Trupi gjykues në rezultatin e hetimit administrativ i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me konstatimin se: (i) Duket se subjekti ka pranuar dhurata në vlerë totale rreth 8,446 euro për udhëtimet e kryera gjatë periudhës 2009 – 2019, të cilat ndikojnë në sjelljen e magjistratis jashtë detyrës; (ii) Subjekti nuk i ka deklaruar këto dhurime në deklaratimet periodike vjetore, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion që provon ofertat me çmim promocional të përfituara nga agjencia turistike për udhëtimet e kryera prej saj; (iii) Shpenzimet për udhëtimet e kryera në periudhën 2004 – 2016 u përlllogarit sipas standardit të Kolegjit, duke u reflektuar në analizën financiare sipas viteve.

**11.3** Subjekti i rivlerësimit në prapësime ka ndryshuar deklarinimin lidhur me shpenzimet për udhëtime, krahasuar me deklaratimet e subjektit në pyetësonin standard, ndryshim ky i cili duket që është bërë në funksion të balancave negative të pasqyruara në barrën e provës.

**11.4** Në drejtim të këtyre shpenzimeve për udhëtime, unë konstatoj se, referuar deklaratimeve në deklaratat periodike vjetore, në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se kostot e udhëtimit janë mbuluar nga mikeshja e saj, znj. E. Gj. Gjithashtu, edhe gjatë procesit të rivlerësimit subjekti nuk ka mundur të paraqesë ndonjë provë apo të dhënë, si promocioni i udhëtimit, pagesë biletash etj., të cilat faktojnë mbulimin e kostove të shpenzimeve të këtyre

<sup>6</sup> Vizitë turistike në \*\*\* në datat 27.11.2009 – 30.11.2009; vizitë turistike në \*\*\* në datat 30.12.2009 – 5.1.2010; udhëtim në \*\*\* në datat 22.8.2013 – 26.8.2013.

<sup>7</sup> Udhëtimet në SHBA, konkretisht në datat 16.5.2014 – 29.5.2014, datë 26.10.2016 – 05.11.2016 dhe 22.3.2019 – 1.4.2019.

udhëtimeve. Të vetmet dokumente të sjella nga subjekti janë vërtetime të lëshuara nga agjencia “\*\*\*”, të cilat konfirmojnë shpenzime të kryera për udhëtimet familjare të subjektit.

**11.5** Gjithashtu lidhur me deklaratimet për shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga viti 2004 deri në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje të shpenzimeve të udhëtimeve midis pyetësorit standard dhe atyre në prapësime të barrës së provës, duke ndryshuar deklaratimin vetëm për vitet ku situata financiare ishte me balancë negative.

**11.6** Më tej, unë, si anëtare në pakicë, konstatoj se nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në asnjë rast nuk janë aplikuar/pranuar që të gjitha shpenzimet, si të udhëtimit, edhe ato të qëndrimit, të mbuluara nga personat e tretë, përveçse kur provohet me dokumentacion ligjor të kohës kur është kryer transaksioni.

**11.7** Në këto rrethana, unë, si anëtare në pakicë, në zbatim të standardit të deritanishëm të aplikuar për evidentimin e kostove të udhëtimit për subjektet e rivlerësimit, çmoj se duhet aplikuar metodologjia e dhënë në vendimin nr. (JR) 11/2019 të Kolegjit, prej së cilës rezultoi se subjekti ka kryer shpenzime për udhëtime, të dhuruara nga mikeshja e saj: (i) për vitin 2009 – 2010<sup>8</sup>, sipas standardit në shumën 109,736 lekë; (ii) për vitin 2013<sup>9</sup> në shumën 192,789 lekë; (iii) për vitin 2014<sup>10</sup> në shumën 142,071 lekë; (iv) për vitin 2016<sup>11</sup> në shumën 141,087 lekë. Shpenzimet për udhëtimet e tjera të kryera në periudhën 2004 – 2016 u përlogarit sipas metodologjisë së dhënë në vendimin e Kolegjit, duke u reflektuar në analizën financiare sipas viteve.

**11.8** Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, unë, si anëtare në pakicë, pas analizimit dhe vlerësimit të kursimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, të deklaruara në deklaratimet për shtesat e kurimeve *cash* në vitet 2004 – 2016 e më pas, në raport me të gjitha faktet e provuara nga aktet shkresore të administruara përgjatë hetimit administrativ, vlerësoj se shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit për subjektin dhe personin e lidhur nga viti 2004 deri në vitin 2016, duhet të përfshihen në analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur. Nga rezultati i analizës financiare duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit sipas metodologjisë së KPA-së, rezultojnë pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vlerën 6,284,267 lekë për vitet 2003 – 2016, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

#### ***Lidhur me dhuratat e deklaruara ndër vite nga nëna e subjektit të rivlerësimit***

**12.** Në deklaratimet periodike vjetore, tek rubrika “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar dhurata nga nëna, konkretisht: (1) në DPV-në e vitit 2007, dhuruar 6,000 euro; (2) në DPV-në e vitit 2008, dhuruar 5,000 euro; (3) në DPV-në e vitit 2010, dhuruar 10,000 euro; dhe (4) në DPV-në e vitit 2011, dhuruar 6,000 euro.

**12.1** Nga analiza financiare e prindërve të subjektit, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat për të cilat është shpjeguar bindshëm burimi i ligjshëm, sipas vlerësimit tim si anëtare në pakicë, personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme për vitin 2007 në vlerën 647,936 lekë, vit kur ka dhurua shumën 6,000 euro.

<sup>8</sup> Vizitë turistike në \*\*\* në datat 27.11.2009 – 30.11.2009; vizitë turistike në \*\*\* në datat 30.12.2009 – 5.1.2010.

<sup>9</sup> Udhëtim në \*\*\* në datat 22.8.2013 – 26.8.2013.

<sup>10</sup> Udhëtimet në SHBA, konkretisht në datat 16.5.2014 – 29.5.2014.

<sup>11</sup> Udhëtimet në SHBA, konkretisht në datat 26.10.2016 – 5.11.2016.

### ***Lidhur me automjetin e blerë në datën 15.5.2014***

**13.** Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si vijon: (i) Duket i paqartë çmimi i blerjes së automjetit në vlerën 6,690 euro, e cila përfaqëson vlerën e mbetur të detyrimit financiar të shtetases A. M. për këtë automjet.

**13.1** Unë, si anëtare në pakicë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm çmimin e blerjes së këtij automjeti, duke paraqitur deklarime kontradiktore lidhur me çmimin e automjetit. Nga njëra anë, subjekti, në funksion të prapësimeve mbi likuiditetin në formën *cash* të vitit 2014 deklaroi se ka qenë një lapsus deklarimi në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 7.7.2016, ndërkohë që në prapësimet në funksion të blerjes së këtij automjeti i qëndron deklarimit në procesverbalin e ILDKPKI-së së datës 7.7.2016 se në vitin 2014 ka pasur gjendje 1 000 000 lekë dhe 5000 euro.

**13.2** Në këto kushte, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, për rrjedhojë, i qëndroj konkluzionit të rezultateve të hetimit se: Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm çmimin e blerjes dhe burimin e krijimit të blerjes së këtij automjeti, duke u gjendur në kushtet e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### ***Lidhur me shumën 30,000 USD të depozituar në datën 14.7.2005***

**14.** Nga të dhënat bankare të subjektit të dërguara nga Intesa Sanpaolo Bank<sup>12</sup> ka rezultuar depozitim i një shume prej 30,000 USD, në datën 14.7.2005.

**14.1** Trupi gjykues i kaloi barrën e provës subjektit me konstatimin se: (i) Duket se ka një mospërputhje në deklaratimet e subjektit lidhur me shumën prej 30,000 USD gjatë hetimit. (ii) Nga analiza financiare kumulative, prindërit e subjektit kanë rezultuar me balancë negative në vitin 2005, ku duket se janë në pamundësi.

**14.2** Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion ligjor provues për të provuar të kundërtën e barrës së provës, në këto kushte, unë, si anëtare në pakicë, i qëndroj konkluzionit të rezultateve të hetimit se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e krijimit të kësaj shume dhe personi tjetër i lidhur/nëna e subjektit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për vitin 2005, duke u gjendur në kushtet e pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### ***Lidhur me të ardhurat e prindërve si kontribuuesit kryesorë në krijimin e pasurive dhe llogarive të subjektit të rivlerësimit***

**15.** Duke qenë se prindërit e subjektit janë kontribuuesit kryesorë të pasurive të subjektit (pasuri të paluajtshme, llogari bankare, likuiditet në formën *cash*) dhe personat e lidhur (vajzat), unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se, ndryshe nga shumica, analiza kumulative e prindërve të subjektit duhet të kryhet duke përfshirë edhe investimet në pasuri, duke qenë se pothuajse çdo shpenzim për pasuri të krijuar i është dhuruar më tej subjektit.

<sup>12</sup> Dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2021.

**15.1** Për këtë arsye vlerësoj se shumica e trupit gjykues nuk duhet të kishte marrë në konsideratë pretendimin<sup>13</sup> e subjektit lidhur me kryerjen e analizës financiare, në të cilën nuk ka marrë në konsideratë investimet e kryera nga prindërit.

**15.2** Unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se ky pretendim i subjektit nuk qëndron në rastin konkret, duke pasur parasysh se çdo pasuri e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* 2017 apo edhe në DPV ka si burim investimet e kryera nga prindërit e subjektit në: (1) apartament në Tiranë në shumën 38,000 USD; (2) apartament në Golem, blerë në vlerën 72,000 euro; (3) një banesë 2-katëshe + papafingo me vlerë të investuar sipas EKB-së në shumën 4,534, 553 lekë; (4) depozita bankare në shumën 67,496 USD, e cila rrjedh nga depozitimi në datën 11.6.2003 nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e saj të shumës prej 52,534 USD; (5) dy llogaritë e vazhde deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017, në shumën totale prej 18.200 USD; (6) 10,000 USD, dhuruar subjektit në vitin 2010; (7) 10,000 USD, dhuruar subjektit dhe deklaruar likuiditet në formën *cash* në deklaratën *Vetting* 2017; (8) e gjithë pasuria trashëgimore e nënës së subjektit i është dhuruar vetëm subjektit dhe jo vëllait të saj, i cili gjatë hetimit deklaroi<sup>14</sup> se ka respektuar vullnetin e prindërve dhe nuk ka pasur asnjëherë pretendime në lidhje me pronat që ata kanë blerë apo i kanë dhuruar motrës së tij. Nga dokumentacioni i administruar nga bankat rezultoi se vëllai i subjektit kishte marrë kredi në vitin 2009 për të financiar blerjen e apartamentit të tij.

**15.3** Për këto arsye, unë vlerësoj se në analizën financiare të prindërve në vite duhet të përfshihen, përveç shpenzimeve të jetesës, edhe të gjitha investimet e kryera nga prindërit, duke përfshirë edhe investimet e tyre personale.

**15.4** Në këto kushte, vlerësoj se personat e tjerë të lidhur/nëna dhe babai i subjektit, në cilësinë e dhuruesve, kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të mbuluar investimet në pasuri, të cilat i janë dhuruar subjektit.

**16.** Në konkluzion për kriterin e pasurisë lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting* 2017 dhe sqarimet gjatë hetimit të Komisionit, unë, si anëtare në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit në tërësinë e deklaramit të saj ka pasuri në pronësi dhe në përdorim të pajustikuar me burime financiare të ligjshme, si dhe është përpjekur të mos deklarojë saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur. Subjekti është përpjekur për të siguruar dokumentacion dhe ka bërë deklaramime, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me provat shkresore të administruara gjatë hetimit, si dhe është përpjekur të konfundojë Komisionin në hetimin e pasurisë së saj. Për rrjedhojë, sipas vlerësimit tim, subjekti

---

<sup>13</sup> Komisioni nuk duhet të kryejë një analizë financiare të prindërve duke përfshirë edhe investimet e kryera, pasi për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhuruar apo dhënë hua dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, sipas jurisprudencës së Kolegjit.

<sup>14</sup> Deklaratë noteriale të lëshuar në datën 14.7.2023 nga vëllai i saj E. S., i cili deklaroi se ka respektuar vullnetin e prindërve dhe nuk ka pasur asnjëherë pretendime në lidhje me pronat që ata kanë blerë apo i kanë dhuruar motrës së tij. Më tej, z. E. S. deklaroi se shumë vite ka jetuar jashtë vendit dhe nuk ka pasur nevojë për ndihmën financiare nga prindërit, të cilët janë treguar të gatshëm dhe gjithmonë e kanë pyetur nëse ka pasur nevojë për ndihmë financiare. Pas ndarjes nga jeta të babait në datën 12.9.2020, ai deklaroi se ka përfutur 2/3 nga llogaritë bankare në emër të babait (pjesa e tij takuese sipas dëshmisë së trashëgimisë dhe pjesa e nënës, përfutur nga kjo trashëgimi). Z. E. S. deklaroi se është i interesuar dhe ka shprehur dëshirën për të përfutur më shumë pjesë nga pronat e nënës në \*\*\*, pas finalizimit të aktmarrëveshjes datë 21.8.2012, duke pasur gjithmonë edhe dakordësinë e motrës Suela Salavaçi. Vëllai i subjektit gjithashtu deklaroi se nuk ka nënshkruar asnjë lloj kontrate dhurimi, shitje me prindërit e tij.

i rivlerësimit, znj. Suela Salavaçi, nuk ka krijuar një nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë.

**17.** Për këtë arsye, unë, si anëtare në pakicë, bazuar në prova dhe bindjen e brendshme, vlerësoj se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, por shkarkimin e saj nga detyra, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Etleda ÇIFTJA**  
**Anëtare (kundër)**